

UDHËZIM
Nr. 6, datë 27.2.2023

PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË
ARSIMIT FILLOR, VITI SHKOLLOR 2023

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 26, nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 22 maj 2023, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.
 2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.
 3. Për nxënësit e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase pjesa e testit që përfshin lëndët e matematikës dhe diturisë së natyrës të jetë në gjuhën e tyre amtare.
 4. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor fillon në orën 10:00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.
 5. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet testi.
 6. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren, “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”, miratuar me urdhrin nr. 78, datë 27.2.2020.
 7. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe nevojat e tyre.
 8. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.
 9. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.
 10. Arkivimi i testeve bëhet pranë zyrave vendore të arsimit parauniversitar.
 11. Zyra vendore e arsimit parauniversitar merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, në DPAP dhe në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.
 12. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi